



UNMIK



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrit

Cabinet of the Minister

Kabinet Ministra

**ANEKSI -I - I UDHËZIMIT ADMINISTRATIV NR. 10/2006 PËR
GRUMBULLIMIN E MJETEVE FINANCIARE VETANAKE NË
ADMINISTRATËN E MASHT-IT DHE SHFRYTËZIMIN E
TYRE**

NUMËR: MASHT[I] 22/2006

DATË: 06.6.2006

Në bazë të nenit 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr.2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, dhe në bazë të nenit 10.3, të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, si dhe neni 4 paragrafi 4.1 pika (k), të Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Kosovë, si dhe Udhëzimit Administrativ nr.10/2006 për grumbullimin e mjeteve financiare vetanake në administratën e MASHT-it dhe shfrytëzimin e tyre, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (më tutje MASHT) nxjerr Aneksin - I - të Udhëzimit Administrativ nr. 10/2006:

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij Aneksi -I - është ndryshimi i nenit 3 pikat (a) dhe(e), të Udhëzimit Administrativ nr. 10/2006 për grumbullimin e mjeteve financiare vetanake në administratën e MASHT-it dhe shfrytëzimin e tyre.

Neni 2

Shuma e mjeteve

1. Ndryshohet neni 3 pika (a) e Udhëzimit Administrativ nr. 10/2006 i cili do të ketë këtë përmbajtje:

- për lëshimin e vendimit për nostrifikimin e dokumenteve pa diplomë të nivelit fillor dhe të mesëm palët do të paguajnë nga 10 €
- për lëshimin e vendimit për nostrifikimin e dokumenteve dhe diplomës të nivelit fillor dhe të mesëm, palët do të paguajnë nga 20 €

2. Ndryshohet edhe pika (e) e këtij Udhëzimi Administrativ, e cila do të ketë për qëllim rregullimin e çështjes së pagesës për verifikimin dhe vulosjen e dokumenteve shkollore për dërgim jashtë shtetit si vijon:

- për një dokument të arsimit parauniversitar (qoftë vërtetim për statusin e nxënësit, dëftesë apo diplomë), parashtruesi i kërkesës do të paguajë shumën prej 5 €
- për më shumë se një dokument shkollor të arsimit parauniversitar (dëftesë, diplomë etj.), parashtruesi i kërkesës do të paguajë shumën prej 10€
- për një dokument të arsimit universitar (qoftë diplomë, certifikatë të notave, vërtetim të statusit të studentit), parashtruesi i kërkesës do të paguajë shumën prej 10€
- për më shumë se një dokument të arsimit universitar (diplomë, certifikatë të notave, vërtetim të statusit të studentit, etj.), parashtruesi i kërkesës do të paguajë shumën prej 15 €

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky Aneks –I- i Udhëzimit Administrativ nr. 10/2006 hyn në fuqi me dt.06.6.2006.

Agim Veliu, ministër